VENDIM
Nr.82, datë 14.12.2011

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR LICENCIMIN, ORGANIZIMIN, VEPRIMTARINË DHE MBIKËQYRJEN E ZYRAVE TË KËMBIMIT VALUTOR"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1 pika 4, shkronja "b"; nenit 12 shkronja "b"; nenit 43 shkronja "c"; nenit 61 shkronja "b" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të nenit 126 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor", miratuar me vendimin nr.31, datë 6.6.2007 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) përmbajtja e nenit 6, pika 1 ndryshon, si më poshtë vijon:

i) shkronja "a" ndryshon si vijon, cit: "Ekstraktin e regjistrit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, për regjistrimin e subjektit si person juridik, në të cilin të jetë e shprehur si objekt i veprimtarisë së shoqërisë, veprimtaria financiare e këmbimeve valutore";

ii) te nënpika "iii" e shkronjës "b", pas fjalës "penalisht" shtohen fjalët "ose formularin e vetëdeklarimit, sipas aneksit nr.4 të kësaj rregulloreje".

iii) pas shkronjës "g" shtohen shkronjat "h", "i" dhe "j", me përmbajtje si më poshtë vijon:

- h) Deklaratën e nënshkruar nga administratori i personit juridik, sipas aneksit nr.5 të kësaj rregulloreje, mbi njohjen dhe zbatueshmërinë e detyrimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi për ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor;

- i) informacion mbi pajisjet e nevojshme teknike/administrative që zyra disponon për ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor, siç listohen në aneksin nr.6, bashkëngjitur dhe pjesë e kësaj rregulloreje;

- j) informacion mbi mjediset dhe kushtet e sigurisë për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor, në zbatim të akteve nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë për këtë qëllim. Në këtë dokument jepet informacion minimalisht për instalimin e sistemit të monitorimit dhe të telekamerave, mbi kasafortën për ruajtjen e vlerave monetare, si dhe për ndarjen e zonës së arkës.".

b) përmbajtja e nenit 7 pika 1 shkronja "a" ndryshon si më poshtë vijon:

- "Ekstraktin e regjistrit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit për regjistrimin e subjektit si person juridik, në të cilin të jetë shprehur si objekt i veprimtarisë së shoqërisë, veprimtaria e agjentit për transferimin e parave në emër dhe për llogari të subjektit financiar jobankë".

c) Përmbajtja e nenit 9 pika 4 ndryshon si më poshtë vijon:

i) Në fjalinë e parë hiqen fjalët "të kushteve teknike dhe";

ii) shfuqizohet fjalia e dytë e kësaj pike.

d) Përmbajtja e nenit 11 ndryshohet si më poshtë vijon:

i) Në fjalinë e dytë, pas fjalëve "nenit 8, pika 2" shtohet "neni 6 pika 1, shkronja "i" dhe fjalët "kushtet teknike dhe të" zëvendësohen me shkronjën "e"".

e) Përmbajtja e nenit 17 ndryshon si më poshtë vijon:

i) në paragrafin e parë hiqen fjalët "luftës kundër";

ii) në shkronjën "a", pas fjalës "klientit" shtohen këto fjalë "sipas dokumentacionit të kërkuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi".

f) Pika e 2 (dytë) e nenit 25 shfuqizohet.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ardian Fullani